



Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale, shikimi publik



Një nga projektet kapitale të relaizuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës është edhe projekti për rindërtimin e informacioneve kadastrale (RIK), respektivisht harmonizimin e gjendjes së pronave në terren me ato në regjistrat në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK). Ky projekt konsiston me tre faza kryesore, respektivisht **faza e informimit publik** që kishte për qëllim informimin e qytetarëve mbi aktivitetet e projektit, përfitimet nga projekti e ngjashëm, dhe ku nga qytetarët u kërkua pjesëmarrje sa më aktive në projekt, pasi që edhe suksesi i projektit varret nga kjo gjë. Faza e dytë është **faza e matjeve në terren**, gjatë të cilës fazë ekspertët e operatorit ekonomik, në prezencën e vetë pronarëve dhe nën monitorimin e Komisionit, kryen matjen e pronave, dhe evidentuan gjendjen e re të pronave, dhe e treta dhe e fundit është **faza e shikimit publik**, që ka për qëllim që në një **afat prej 60 ditësh** paraqitjen e gjendjes së re të pronave të matura në kuadër të projektit para banorëve të Zonave në rindërtim dhe diskutim mbi këto rezultate. Qytetarët gjatë shikimit publik kanë të drejtë të pranojnë ose kontestojnë gjendjen e re të pronave, e cila vetëm pas pranimit të tyre do të regjistrohet.

RIK, takim me përfaqësues të Komisionit për Rindërtim

Po ashtu, me qëllim të informimit edhe përgatitjes së anëtarëve të Komisionit për Rindërtim të Informacioneve Kadastrale që vijnë nga Zonat e Rindërtuara për këtë fazë, ekspertët ligjor e kadastral të AKK-së, përfshi edhe Kryetarin e Komisionit për RIK, me datë 25 korrik në ambientet e AKK-së kanë mbajtur takim pune me të gjithë përfaqësuesit e Komisionit për Rindërtim të Informacioneve Kadastrale që vijnë nga vetë Zonat në rindërtim. Në takim përfaqësuesit e Zonave përmes debateve interaktive janë informuar për aktivitetet dhe përgjegjësitë e tyre gjatë kësaj faze. Ekspertët e AKK-së janë shprehur të gatshëm që të ndihmojnë aktivitete në çfardo mënyrë që do të jetë e nevojshme, krejt me qëllim të përfundimit të suksesshëm të projektit.

Vizita zonave në rindërtim

Me qëllim të monitorimit të punëve në terren në kuadër të Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale një ekip i AKK-së ka ndërmarrë një vizitë në terren, ku kanë takuar banorë të Zonave Kadastrale dhe përmes shkëmbimit të informacioneve mbi ecurinë e projektit, për së afërmi i kanë inkurajuar të njëjtit që të marrin pjesë aktive në projekt. Ekspertët e AKK-së në një nga vizitat në terren kanë qenë të shoqëruar edhe nga deputetja e zonës në fjalë, z-nja Ganimete Musliu e cila po ashtu ka biseduar me banorët e Baksit, dhe kërkoi nga ta që të participojnë në projekt duke theksuar se shumë nga aktivitetet e projektit të cilat në rrethana normale kryhet me pagesë, brenda projektit kryhen pa pagesë.



Komuna	Nr.	Zona Kadastrale	Shikimi Publik	
			Data e hapjes së Shikimit Publik	Vendi
Viti	1	Zhiti	29.07.2019	Rruga kryesore, në qendër të fshatit
	2	Pozharan	29.07.2019	Objekti i qendrës rinore
	3	Sllatinë	29.07.2019	Pranë udhërryqit që dërgon në Sodovinë të Jerlive
	4	Sadovinë e jerlive	29.07.2019	Rruga kryesore, mbrapa pomës “Toni”
Kamenicë	1	Hodonoc	29.07.2019	Në hyrje të fshatit Hodonoc
	2	Rogaçicë	29.07.2019	Afër Xhamisë, te libraria “Mimi”
	3	Muçiverc	29.07.2019	Objekti i ish zyrës së vendit
	4	Kopërnice	29.07.2019	Në objektin e Fatmir Beqirajt
	5	Berivojcë	29.07.2019	Ish restorant “Familja”
Skënderaj	1	Çirez	24.06.2019	Zyra e gjendjes civile
	2	Baks	24.06.2019	Zyra e gjendjes civile
	3	Dashevc	24.06.2019	Shkolla e Fshatit “Dëshmorët e Qyqavicës”
	4	Kostërc	24.06.2019	Shkolla e Fshatit Runik “Shotë Galica”
Glllogoc	1	Arllat	24.06.2019	Përballë shkollës “Mehdi dhe Sylejman Bytyqi”
	2	Shtuticë	24.06.2019	Rruga Martirët e Shtuticës - Lkalo i Musli Berishës

AKK, takim me kryetarin e Komunës së Obiliqit



Me qëllim të prezantimit të aktiviteteve të Komunës së Obiliq dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës si dhe me qëllim të identifikimit të fushave të interesit të përbashkët në të cilat bashkëpunimi do të mund të avancohej në të ardhmen, me datë 30 korrik në ambientet e Komunës së Obiliqit është mbajtur një takim pune mes Kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe z. Xhafer Gashi dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, të shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët. Në takim kryesisht u diskutua rreth fushave të administrimit

të tokës në përgjithësi dhe kadastrës dhe të drejtave pronësore në veçanti, me theks të veçantë avancimi i shkëmbimit të informacioneve gjeohapësinore, përfundimi dhe kompletimi i sistemit të adresave në këtë komunë, trajtimi i mundësisë për bashkëpunim në rindërtimin e informacioneve kadastrale në disa zona kadastrale të kësaj komune e ngjashëm. Duke marrë parasysh se Kryetari i Komunës së Obiliqit z. Xhafer Gashi është edhe Nënkryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, z. Ahmeti nga i njëjti kërkoi edhe përkrahje në shtyrjen para të Ligjit të ri

për Kadastër. Kryeshefi ofroi përkrahjen e plotë të institucionit që udhëheq në nevojat që Komuna e Obiliqit ka. Sa i përket aspektit teknik, përfaqësuesit e institucioneve u pajtuan që të investohet në ngritjen e aftësive profesionale të personave që operojnë me Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë, e në fusha tjera ku do të paraqitet nevoja. Përfaqësuesit e institucioneve u zotuan në vazhdim të bashkëpunimit në fushat e sipër përmendura, krejt me qëllim të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve sa më kualitative.



Adresat dhe skanimi, bashkëpunim me Komunën e Ferizajt

Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga bashkëpunëtorët ishte në një vizitë pune në Komunën e Ferizajt ku u prit nga Kryetari i Komunës së Ferizajt z. Agim Aliu, Deputeti i zonës z. Elmi Reçica si dhe Drejtori i Kadastrës z. Sabri Murseli. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit mes dy institucioneve lidhur me projektin për vendosjen e numrave të shtëpive në tërë territorin e Komunës së Ferizajt me çka edhe do të kompletohej sistemi i adresave në këtë komunë. Projekti do të financohet nga Qeveria Norvegjeze dhe Komuna e Ferizajt. Po ashtu kjo vizitë

pune u shfrytëzua edhe për monitorimin e punëve të kryera nga Zyra Kadastrale Komunale në këtë komunë me theks të veçantë përgatitjet për projektin "Indeksimi dhe skanimi i dokumenteve të arkivuara kadastrale", që ka për qëllim digjitalizimin e

këtyre dokumenteve. Komuna e Ferizajt ka mirëpritur këtë projekt i cili është në shërbim të qytetarëve dhe i cili do të lehtësojë punën dhe aktivitetet ditore të zyrtarëve të kësaj komune, dhe do të rezultonte me shërbime më të mira dhe më efikase.



AKK, ndryshon orari i punëve me palë

Agjencia Kadastrale e Kosovës informon të gjithë qytetarët se prej datës 29 Korrik 2019, konsultimet me palë do të bëhen vetëm të martën dhe të enjten, prej orës 09:00 -12:00 si dhe prej orës 13:00-15:00. Ndërsa pranimi i kërkesave dhe ankesave do të vazhdojë të kryhet secilën ditë pune, brenda orarit zyrtar. Parashtruesit e kërkesave duhet t'i dorëzojnë kërkesat në Zyrën Pritëse, në katin përdhese të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, pasi t'i bashkëngjisin kërkesës të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Kërkesat të cilat do të rezultojnë me mungesë dokumentacioni, nuk do të pranohen deri në kompletimin e tyre, dhe kjo çështje mbetet përgjegjësi e palëve.

Sa i përket kërkesave nga Komunitat Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, të njëjtat do të pranohen gjatë secilës ditë brenda orarit të punës, ndërsa produktet/shërbimi do të merren ditën e nesërme, nga ora 13:15 – 15:30. Kërkesat për produkte të AKK-së, do të pranohen secilën ditë pune brenda orarit të punës. Produkti për kërkesat që do të dorëzohen prej orës -9:00 deri 11:30

paradite, do të merret pasditen e ditës së njëjtë, nga ora 14:00 -15:30. Kërkesat për produkte që dorëzohen pasdite merren ditën e nesërme nga ora 9:00 deri me 11:30. Një gjë e tillë do të mundësojë Agjencinë Kadastrale të Kosovës që të ofrojë shërbime dhe produkte sa më kualitative dhe brenda afateve të përcaktuara me ligj.



Instrument i ri gjeodezik “Total Station”



Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës është bërë pranim dorëzimi i Instrument të ri gjeodezik, i cili do të përdoret për nevoja të matjeve kadastrale. Instrumenti i ri gjeodezik “Total Station” është robotik nga

prodhuesi TOPCON i modelit, GT 1002. Ky instrument do të ndikoj në ngritjen e cilësisë së matjeve në terren për nevoja të projekteve të cilat realizohen në AKK, për kontrollin e kualitetit të të dhënave nga

Rindërtimi i informacioneve Kadastrale (RIK), krijimi i modelit digjital të terrenit (DTM), etj. Në takim me rastin e pranim të këtij Instrumenti, Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, ndër të tjera tha se ky instrument do të jetë ndihmë e madhe për ekspertet gjatë matjeve në terren. Ky instrument është modeli i fundit i prodhimit i këtij lloji, i cili do të lehtësoj punën e stafit në vazhdimësi. Po ashtu është paraparë edhe trajnimi dy ditorë për stafin e AKK – së, të cilët merren me matjet në terren. Blerja e instrumentit është financuar nga buxheti i Kosovës.

Adresat, avancim i kornizës ligjore

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka ndërmarrë disa iniciativa ligjore për të ngritur shkallën e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve të cilat ajo i ofron. Konkretisht, së fundmi me qëllim të avancimit të kornizës ligjore që rregullon mandatin dhe përgjegjësitë e saj, AKK ka bërë azhurnimin e 10 Udhëzimeve Administrative, në mesin e të cilave edhe 5 Udhëzimet Administrative për Sistemin e Unifikuar të Adresave. Me qëllim të prezantimit të ndryshimeve dhe efekteve që këto udhëzime do të kenë në punën e përditshme të zyrtarëve të cilët mirëmbajnë adresat, AKK ka mbajtur një takim pune me Drejtorët e Urbanizimit

nëpër Komunitat e Kosovës. Gjatë prezantimeve profesionale dhe debateve interaktive, ekspertët e AKK-së nga Njësia e Adresave në AKK, kanë dëgjuar komentet e përfaqësuesve komunal, krejt me qëllim të tejkalimit të sfidave që janë paraqitur gjatë implementimit të Sistemit të Unifikuar të Adresave. Takimi u udhëhoq nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti i cili prezantoi edhe aktivitetet që AKK ndërmerr në aspektin e përfundimit të sistemit të të adresave në tërë territorin Republikës së Kosovës. I njëjti po ashtu u zotua që do të përkrahë Drejtorit e Urbanizimit sa herë që të ketë nevojë.



Informata mbi AKK

AKK është organ kompetent për kadastër, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi, për sistem të adresave dhe infrastrukturë të të dhënave gjeohapësinore

KRYESHEF EKZEKUTIV
Avni Ahmeti
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORATI I KADASTRËS
Korab Ahmetaj
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

DREJTORATI LIGJOR
Bashkim Shaqiri
bashkim.shaqiri@rks-gov.net

DREJTORATI I FINANCEVE
DHE ADMINISTRATËS
Fazile Hamiti
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORATI I TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT
Aferdita Thaci
Aferdita.Thaci@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË
Ibadete Rexhepi
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE
INFORMATA TË PËRGJITHSHME
akk@rks-gov.net

Komunitat e veriut, takim pune me UN - HABITAT

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga ekspertë kadastral e ligjorë priti në takim pune përfaqësuesen e zyrës së UN-HABITAT në Kosovë znj. Arieta Himaduna dhe Drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit në këtë Komunë z. Goran Luzoviç. Temë e këtij takimi ishte fillimi i bashkëpunimit institucional mes AKK-së dhe Komunitës së Leposaviqit në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, sfidat dhe problemet me të cilat përballen banorët e asaj komunë me pajisjen me certifikata të pronësisë dhe kryerjen e shërbimeve kadastrale. Kryeshefi

i AKK-së z. Ahmeti ngriti shqetësimet e tija për mosfunksionimin e Zyrave Kadastrale Komunalet në Leposaviq, rrjedhimisht mungesën e ofrimit të shërbimeve kadastrale për qytetarët e kësaj Komune. Për pasojë, qytetarët e këtyre Komunitave po detyrohen që këto shërbime të marrin në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, që rezulton me kohë, mund dhe shpenzime shtesë për ta. Kryeshefi i AKK z. Ahmeti shtoi se Agjencia Kadastrale e Kosovës është e gatshme tu ofrojë ndihmë në aspektin teknik, infrastrukturual dhe profesional, madje edhe në realizimin e projekteve konkrete në Komunitën e Leposaviqit.

